**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE I PËRGJIGJEVE TË VITIT 2024**

**(Prill-Maj-Qershor)**

| Nr. Rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 10 | 28/03/2024 | 1.Listën e dokumentave ekzistuese referuar fushës së veprimtarisë tuaj, që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura, dhe publikimin e saj.<br>2.Disponueshmërinë e tyre, nëse ripërdorimi I dokumentave bëhet kundrejt një tarife të miratuar ose jo.Nëse po, duhet të keni në konsideratë parashikimet referuar pikës 5 të nenit 10 të ligjit nr. 33/2022, cituar me lart.<br>3.Caktimin e personit të kontaktit I cili do të raportojë në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e këtij proçesi në institucionin tuaj. | 16/04/2024 | 1.**Të dhëna të përgjithshme;**<br>- Plani i përgjithshëm vendor Belsh,<br>- Vendim nr.2 dt.17.03.2021 i KKT Rishikimi PPV Belsh,<br>- Shtojca II kordinatat PPV Belsh,<br>- Dokument i rishikimit PPV Belsh,<br>- Vendim nr.KKT dt.27.02.2019,<br>- Plani i zhvillimit Belsh,<br>- Rregullorja,<br>- Strategjia territorial,<br>- VSM,<br>- Harta e përdorimit të tokës sipas kategorive përkatëse,<br>- Harta e ndarjes së territorit në sisteme,<br>- Harta e infrastrukturave të transportit,<br>- Harta e fazimit të zbatimit të PPV,<br>- Harta e vizionit strategjik,<br>- Harta e ndarjes së territorit në zona dhe njësi, | E plotë | Pa pagesë |

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE I PËRGJIGJEVE TË VITIT 2024**

**(Prill-Maj-Qershor)**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | - Programi i transparencës Belsh,<br>- Administrata e bashkisë Belsh,<br>- Ndryshimet ligjore,<br>- Struktura e bashkisë Belsh,<br>- Aparati qendror dhe njësitë administrative të bashkisë Belsh,<br>- Struktura e punonjësve.2.Ripërdorimi i këtyre dokumentave nuk bëhet kundrejt një tarife.3.Fatmira Broshka fatmira.broshka@bashkiabelsh.gov.al | | |
| 11 | 11/04/2024 | 1.Na vini në dispozicion një kopje të Projektit Artistik i Ansamblit Rilindja?<br>2.Na vini në dispozicion preventivin përfundimtar të vlerës së këtij projekti/sa ka kushtuar? | 30/04/2024 | Preventivi kyoScan-_4_._16_._2024-_9_._46_._05.pdf<br>Kopje e Projektit kyoScan-_4_._16_._2024-_11_._32_._34.pdf | E plotë | Pa pagesë |

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE I PËRGJIGJEVE TË VITIT 2024**

**(Prill-Maj-Qershor)**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | 07/05/2024 | 1.Sa është numri i stacioneve të MZSH në bashkinë tuaj?2.Sa është numri total i makinave zjarrfikëse në bashkinë tuaj ?3.Sa është numri i efektivëve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit ( zjarrfikës dhe punonjës)4. Cilit vit i përkasin automjetet zjarrfikëse dhe a mund të specifikoni nëse janë blerë nga fondet e bashkisë apo donacionet?5. A ka Bashkia plane afatshkurtra për blerje mjetesh të reja apo investime lidhur me këtë program? | 20/05/2024 | 1.Bashkia Belsh ka 1 stacion të MZSH.2. Bashkia Belsh ka në total 2 makina zjarrfikëse.3. Bashkia Belsh ka 14 efektivë të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit (zjarrëfikës dhe punonjës.4. Makinë zjarrëfikëse MANN, viti 1975 Makinë zjarrëfikëse RENAULT, viti 1993<br>Njëra nga makinat zjarrëfikëse është dhuratë nga Bashkia Elbasan, ndërsa tjetra është blerë nga fondet, që ka çelë ministria përkatëse. 5. Jo, bashkia nuk ka plane afatshkurtra për blerje mjetesh të reja apo investime për vitin 2024 sipas programit. | E plotë | Pa pagesë |
| 13 | 22/05/2024 | 1. Na vini ne dispozicion lejen e ndertimit dhe projektin e pallatit 6 katesh (Perla e Dumrese) qe ndodhet ne qender te Belzhit?2. Na vini ne dispozicion projektin dhe preventivat e Terminalit te qytetit i cili do te ndertohet tek fusha ku eshte perdorur nga tregetaret e rrobave te perdorura?3. Na vini nedispozicion projekti | 27/05/2024 | Për pikën 1 : po ju dërgojmë lejen e ndërtimit të pallatit “Perla e Dumresë” ;Përsa i përket pikës 2, ju sqarojmë se ndërtimi i terminalit të autobuzave është parashikuar si një investim për t’u realizuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Belsh, I cili do të përmirësoj transportin ndërqytetas në bashki dhe do të ndikojë në ekonomizimin e shërbimit të transportit publik.Për | E plotë | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | n dhe preventivat e Tregut Agro Ushqimor nje projekt i financuar nga AZHBR-ja ne vitin 2020? | | pikën 3 po ju vendosim në dispozicion:-Shkresa mbi miratimin e investimit me nr. 1590/1 prot datë 21.06.2022 për ndërtimin e tregut nga Agjensia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ;-Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.46 datë 06.07.2022 mbi miratimin e " Investim në ndërtimin e tregut bujqësor-blegtoral Belsh";-Formular i njoftimit të kontratës së nënshkruar i publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike të APP-së Nr. 152 datë 07.11.2022;-Projektin dhe Preventivin e ndertimit të investimit. | | |
| 14 | 27.05.2024 | Në kuadër të përgatitjes së rekomandimeve për gatishmërinë dixhitale të bashkisë nën vëmëndjen e veçantë të Ministrit të Shtetit për Qeverisjen Vendore, ekipi i projektit IDRA ka nevojë për ndihmën tuaj për të mbledhur informacionin si më poshtë:1.Numrin total të punonjësve të TIK sipas organikës dhe strukturës më të fundit që ka miratuar bashkia juaj?2. Drejtorinë pranë së cilës gjenden pozicionet eTIK? 3.Sektorin pranë së cillit gjenden | 28/05/2024 | Bashkia Belsh ka 1 pozicion IT.<br>1.Drejtoria e Ndihmes Juridike dhe Sektori i Teknologjise së Informacionit.<br>2.Sektori i Teknologjisë së Informacionit.<br>3.Përgjegjëse e IT.<br>4.Teknologji Informacioni<br>5. Numri i Vakancave 0 | E plotë | Pa pagesë |

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE I PËRGJIGJEVE TË VITIT 2024**

**(Prill-Maj-Qershor)**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pozicionet e TIK?4.Titullin e pozicionit?5.Profilin e edukimit të pozicionit?6.Numri i Vakancave për pozicionet që ndodhen në strukturë por janë vakante aktualisht? | | | | |
| 15 | 06.06.2024 | Për arsye studimi dhe punimi të temës së diplomës, kërkojmë nga ana juaj informacion historik rreth Bashkisë Belsh dhe strukturën e saj? | 06.06.2024 | Përsa i përket historikut, Belshi ka qenë Komunë që përfshinte të gjithë zonën e Dumresë.Pas çlirimit në këtë zonë (1945-1946) pushteti ka funksionuar me kryepleqësi dhe në vitin 1947 u formua lokaliteti i Belshit.Gjithashtu në këtë zonë u krijua dhe lokaliteti i Kajanit në vitin 1958.Deri në vitin 1970 pushteti ishte i organizuar me lokalitete në Belsh e Kajan dhe Këshille Popullore të Fshatrave.Pas këtij viti me zmadhimin e kooperativave bujqësore , pushteti u organizua me Këshill Popullor të Bashkuar dhe Këshille Popullore të Fshatrave.Ndërsa Bashkia Belsh, është krijuar në vitin 1992. | E plotë | Pa pagesë |

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE I PËRGJIGJEVE TË VITIT 2024**

**(Prill-Maj-Qershor)**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 16 | 03.06.2024 | **1.**A ka pasur bashkia juaj buxhet vjetor të planifikuar për rininë(grupmoshën 15-29) për periudhën Janar-Dhjetor 2023? Nëse po, sa përqind e shumës totale zënë këto zëra? Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka një planifikim të tillë?**2.**Sa është numri total i punonjësve në bashkinë tuaj (2023)? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë?**3.**Sa është numri i të rinjve (18-29) punonjës të bashkisë tuaj në vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara?**4.**Sa është numri (18-29) të punësuar në bashkinë tuaj, të cilët mbajnë pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse ? (zv.kryetar, drejtor, etj). Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara, edhe sipas gjinisë?**5.**A ka bashkia juaj politika rinore të | 12.06.2024 | **1.**Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 nuk ka patur buxhet vjetor të planifikuar për rininë, sepse nuk ka patur kërkesa nga zyra përkatëse.<br>**2.** Numri total i punonjësve 225<br>Femra 100<br>Meshkuj 125<br>Persona me aftësi të kufizuara 4<br>Femra 0<br>Meshkuj 4<br>**3.** Numri i të rinjve (18-29) vjec punonjës në bashki 40<br>Femra 32<br>Meshkuj 8<br>Persona me aftësi të kufizuara 0<br>**4.** Numri i punonjësve (18-29) në pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse 2<br>Femra 1<br>Meshkuj 1<br>Persona me aftësi të kufizuara 0<br>**5.**Bashkia Belsh nuk ka politika rinore të zhvilluara specifkisht për këtë grupmoshë, një nga arsyet për mosrealizimin e këtyre politikave është mungesa e stafit dedikuar të rinjve.<br>**6.**Në institucionin tonë është vetëm një punonjëse (specialiste) për Sportin dhe Rininë në Sektorin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Arsimore, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ky sektor është funksional prej afër pesë | E plotë | Pa pagesë |

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE I PËRGJIGJEVE TË VITIT 2024

(Prill-Maj-Qershor)

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | zhvilluara specifikisht për grupmoshën 15-29 vjeç? Nëse jo, ju lutem a mund të na tregoni disa nga arsyet përse nuk ka të zhvilluar një politikë të tillë?**6.**A keni në institucionin tuaj, drejtori, sektorë, staf të dedikuar për rininë? Prej sa kohësh janë funksionale?**7.**A ka struktura rinore të ngritura në bashkinë tuaj dedikuar grupmoshës së të rinjve 15-29 vjeç ( qendra/zyra rinore, këshilla rinore, parlament rinor, struktura konsultative rinore, etj.) për periudhën janar-dhjetor 2023. Nëse po, cilat janë?**8.** Me kë keni bashkëpunuar për ngritjen e strukturave të tilla (organizata rinore, grupe të rinjsh, individë, etj.)?**9.** A keni një plan veprimi për Këshillin Rinor Vendor (KVR)? Sa aktivitete janë organizuar nga KVR përgjatë 2023.**10.** Sa të rinj janë të përfshirë në KVR? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Sa prej tyre i përkasin personave me aftësi të kufizuara , edhe sipas | | vitesh.<br>**7.**Në institucionin tonë është ngritur vetëm Këshilli Vendor Rinor.<br>**8.** Për ngritjen e kësaj strukture kemi patur bashkëpunimin e të rinjve dhe Drejtorit të gjimnazit të Belshit, dhe të vullnetarit të Korpusit të Paqes.<br>**9.** Nuk kemi një plan veprimi për Këshillin Rinor Vendor, ndërsa përsa i përket aktiviteteve nuk ka patur organizime nga KVR përgjatë vitit 2023.<br>**10.** Në Këshillin Vendor Rinor janë të përfshirë pesë të rinj.<br>Femra 4<br>Meshkuj 1<br>Persona me aftësi të kufizuara 0<br>**11.** Përgjatë vitit 2023, në muajin Shtator ka nisur një bashkëpunim, në një projekt me QSHINJNV me në fokus shëndetin mendor tek të rinjtë. Projekti ka patur një kohëzgjatje prej 9 muaj, ku janë zhvilluar aktivitete të ndryshme, trajnime frytëdhënëse për të rinjtë, tryeza konsultative për probleme të ndryshme të të rinjve.<br>**12.** Pjesëmarrja e të rinjve në konsultimet publike është afërsisht 25% . Një nga mënyrat që përdor bashkia për përfshirjen e tyre, është publikimi dhe njoftimi i | | |

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE I PËRGJIGJEVE TË VITIT 2024

**(Prill-Maj-Qershor)**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | gjinisë?**11.** A keni pasur ju forma të tjera të bashkëpunimit (me grupe të rinjsh, organizata rinore, etj) për zhillimin e aktiviteteve me fokus rininë? Nëse po ku kanë konsistuar ato?**12.** Sa është me përafërsi pjesëmarrja e të rinjve në konsultimet publike të zhvilluara nga bashkia? Cilat janë disa nga mjetet apo mekanizmat që përdor bashkia në përfshirjen e të rinjve në të tilla proçese?**13.** Lutemi listoni mjetet e komunikimit që përdor bashkia juaj dhe link përkatëse të faqes së webit të bashkisë (website) dhe rrjetet sociale si Facebook dhe Instagram?**14.** Sa është numri total i përfituesve nga Skema e Ndihmës Ekonomike për vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?**15.**Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) përfitues nga Skema e Ndihmës Ekonomike për vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?**16.**Sa është numri total i përfituesve të Pagesës | | konsultimit publik në rrjetet sociale, ku edhe aksesi nga të rinjtë është me i lartë.<br>**13.** Mjetet e komunikimit:<br>arif.tafani01@hotmail.com<br>bashkiabelsh@hotmail.com<br>https://bashkiabelsh.al/<br>https://www.facebook.com/bashkiabelsh2015?mibextid=LQQJ4d<br>https://www.facebook.com/profile.php?id=100063701572345&mibextid=LQQJ4d<br>https://www.instagram.com/arif_tafani_faqja_zyrtare?igsh=MmMzZWE5Z2ZzcjNk<br>**14.** Numri total i familjeve 673<br>Numri total I individëve 2611<br>Femra 1310<br>Meshkuj 1301<br>**15.** Numri total është 150<br>Femra 80<br>Meshkuj 70<br>**16.** Numri total është 690<br>Femra 354<br>Meshkuj 336<br>**17.** Numri total është 44<br>Femra 24<br>Meshkuj 20<br>**18.** Institucioni jonë nuk ka Shërbime të Kujdesit Shoqëror të ngritur, por kur ka raste të tilla trajtohen nga OJF.<br>**19.** Numri total është 0 | | |

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE I PËRGJIGJEVE TË VITIT 2024**

**(Prill-Maj-Qershor)**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?**17.**Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? **18.** Sa është numri total i personave të cilat janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2023? Sa prej tyre femra dhe sa meshkuj? **19.** Sa është numri i të rinjve (15-29 vjeç) të cilat janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2023? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj? | | | | |